

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndaj të njëjtin mendim me shumicën e trupit gjykues për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Broci, gjyqtar i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, paraqes argumentet për qëndrimin tim në pakicë si vijon:

1. Sipas shumicës, subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të disa pasurive dhe përmbushjes së detyrimeve financiare në lidhje me pasuritë e pikave 217 e 224 të vendimit të saj, si dhe për pasurinë shtëpi në ***, Durrës.

Nuk bie dakord me shumicën për konkluzionin e arritur në këtë rast se, për sa më poshtë vijon:

1.1 Në lidhje me të ardhurat nga qiratë e dyqanit prej 63 m², pranë “*” (pika 223)**

1.1.1 Marrëdhëniet e qirasë për ambientin e mësipërm janë deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit, që në deklarin e parë në vitin 2004 pranë ILDKPKI-së dhe në vazhdim.

1.1.2 Ky dyqan ka pasur qiramarrës nga viti 1996 e deri në vitin 1998 z. G. M që ishte pronar i pasurisë kufitare, nga viti 1998 e deri në vitin 2012 z. E. R, i cili ushtronte aktivitet tregtar në përpunimin dhe tregtimin e produkteve prej qeramike, dhe pas vitit 2012 “R” me të cilin marrëdhënia e qirasë vazhdon edhe sot).

1.1.3 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pagesa e tatimit në burim është kryer rregullisht nga ai deri në vitin 2001. Më pas, me ndryshimet ligjore, këto pagesa janë kryer nga qiramarrësi.

1.1.4 Shkresa e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, nr. ***prot., datë 27.01.2017, konfirmon se për këtë pasuri është paguar tatim në burim që nga viti 1998 dhe në vazhdim.

1.1.5 Për pagesën e tatimit në burim pas vitit 2001 për ambientin e mësipërm, subjekti i rivlerësimit, i paraqiti Komisionit shkresën e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë nr. *** prot., datë 27.01.2017; shkresën e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë nr. ***, datë 05.07.2018, drejtuar E. R, me NIPT ***.

1.1.6 Në parashikimet e ligjit nr. 8841, datë 11.12.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, se qiramarrësi person fizik/tregtar, paguan tatimin mbi qiranë dhe ka detyrimin ta paguajë atë në organin tatimor si një tatim përfundimtar, dhe pas analizimit të:

(i) Shkresës nr. *** prot., datë 23.04.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet së cilës Komisioni i ka kërkuar mendim të specializuar në lidhje mbi detyrimin e pronarit për pagimin e tatimit në burim kryesisht për vitet 2004 - 2014, deri në vitin 2018.

(ii) Përgjigjes së ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 14.05.2018, me të cilën Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përcakton se qiradhënësi/pronar përjashtohet nga detyrimi që të dorëzojë deklaratë tatimore, në rastet kur qiramarrësi është person fizik/tregtar dhe bën pagesë të qirasë, ai mban në burim (në momentin e pagesës) tatimin mbi qiranë dhe ka detyrimin ta paguajë atë në organin tatimor.

(iii) Përmbajtjes së shkresës nr. *** prot., datë 29.05.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, me lëndë “Në lidhje me tatimin mbi të ardhurat nga qiradhënia”, referon se me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8841, datë 11.12.2001, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, e në vijim, në nenin 33, parashikohet se është qiramarrësi person fizik/tregtar, që paguan shumën e qirasë, mban në në momentin e pagesës tatimin mbi qiranë dhe ka detyrimin ta paguajë atë në organin tatimor si një tatim përfundimtar.

Bazuar në sa më sipër dhe rrethanat e faktit dhe të dhënat e provat e administruara nga hetimi administrativ, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave nga ky ambient, nga viti 2001 e në vazhdim, sipas parashikimeve të nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës.

1.1.7 Për pagesën e tatimit në burim për ambientin e mësipërm, para vitit 2001, detyrim i subjektit të rivlerësimit, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, megjithë kalimin e një kohe të gjatë 20-vjeçare, subjekti arriti të sigurojë e të depozitojë para Komisionit disa mandate të pagimit të tatimit për këtë pasuri ndaj bazuar në parashikimet e nenit 474/1 të Kodit Civil, sipas të cilit: *“Kur pagesat e njëllojta për shlyerjen e detyrimit duhet të bëhen në mënyrë periodike, dëftesat e lëshuara për dy pagesa radhazi prezumojnë kryerjen edhe të pagesave të mëparshme”*

Duke u bazuar edhe në:

(i) autoritetin që ligji i ka dhënë administratës tatimore për të verifikuar nëse personi subjekt i këtij legjislacioni vepron sipas parashikimit ligjor, ka paguar të gjitha detyrimet, mbledh me forcë detyrime tatimore të papaguara, të fillojë procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore.

(ii) rrjedhën logjike, sipas të cilës, nuk mund të rezultojë që një individ ka ushtruar aktivitetin me qera për 1 muaj në vitin 1998, për 3 muaj në vitin 1999, e kështu me rradhë ndër vite.

(iii) shkresën e krijuar nga administrata tatimore, bazuar në mandatat e ruajtura apo të gjetura nga subjekti i rivlerësimit.

(iv) parashikimet e nenit 474/1 i Kodit Civil, rrethanat e faktit dhe të dhënat e provat e administruara nga hetimi administrativ,

vlerësoj se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave nga ky ambient, para vitit 2001 sipas parashikimeve të nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës.

1.2 Në lidhje me të ardhurat e ligjshme të fituara nga qiraja e shtëpisë në Shkodër (pika 217)

1.2.1 Marrëdhëniet e qirasë për ambientin e mësipërm janë deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit, që në deklarin e parë në vitin 2004 pranë ILDKPKI-së dhe në vazhdim.

1.2.2 Këtë banesë e ka administruar nëna e subjektit të rivlerësimit, sipas prokurës së vitit 1999, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.0.1999. Banesa ka pasur qiramarrës gjatë viteve shoqata të huaja që operonin në Shqipëri.

1.2.3 Subjekti i rivlerësimit i shpjegoi Komisionit se për shkak të kohës së gjatë të kaluar; moshës së thyer të nënës së tij, që ka administruar këtë banesë; faktit që banesa e vjetër është rikonstruktuar e gjitha, ndodhet në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave nga kjo pasuri, duke i provuar Komisionit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose të merret në rrugë tjetër.

Ai arriti të gjente e të depozitonte vetëm policat e sigurimit pranë shoqërisë “INSIG” sh.a. për këtë banesë, në emrin e znj. H. B, për vitet 1999 - 2000, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, si fakt provues se shtëpia u jepej me qera të huajve (të cilët kishin kusht sigurimin e shtëpisë) si dhe një kontratë qiraje me z. N. B pas vitit 2011;

1.2.4 Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet nënës i ka drejtuar Zyrës së Postës Shkodër një kërkesë zyrtare për konfirmimin e këtyre pagesave.

1.2.5 Sipas shkresës “Kthim përgjigje”, nr. *** prot., datë 12.07.2018, të Zyrës së Postës Shkodër, është bërë me dije se: *“dokumentacioni për periudhën që kërkoni nuk është më në ruajtje në arkivin e institucionit tonë.” e në këtë mënyrë megjithë masat e marra prej tij për grumbullimin e provave*

për përmbushjen e detyrimit për të provuar ligjshërinë e të ardhurave të krijuara nga kjo pasuri, ai provoi Komisionit se dokumenti nuk mund të bëhet përsëri.

1.2.6 Në këto kushte vlerësoj se subjekti rivlerësimi, mosparaqitja e dokumentave justifikuese është për shkaqe të arsyeshme sipas parashikimeve të nenit 32/2 të ligjit nr.84/2016.

1.2.7 Në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoj se në tërësi, subjekti i rivlerësimit, bazuar në provat që disponon Komisioni e në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave nga kjo pasuri, sipas parashikimeve të nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës.

2. Në lidhje me pasurinë shtëpi në plazh, apartament 147 m², në *, Durrës**

2.1 Shumica arriti në konkluzionin se “deklarimet nuk rezultuan të sakta në përputhje me ligjin e me burime të ligjshme financiare; sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe prova e re e paraqitur nuk sollën ndonjë konkluzion të ndryshëm nga rezultatet e hetimit pasi përsëri mbeti e paprovuar mënyra e përfitimit të pagesës mënyra e likuidimit nga subjekti i rivlerësimit; referuar çmimit të shitjes së këtij apartamenti, miqësisë së vjetër mes z. Broci dhe z. Gj (të deklaruar nga palët) shumica nuk u bind për mënyrën e pagesës së vlerës së apartamentit ndaj z. Broci për këstin e parë dhe të dytë të saj; subjekti ka kryer deklarim të rremë lidhur me vlerën reale të blerjes së kesaj pasurie”.

2.2 Nuk bie dakord me shumicën për konkluzionin e arritur lidhur me burimet e ligjshme, pasi në vijim të argumentimit lidhur me të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit nga unë si anëtare pakice, në pikën 1, të këtij mendimi pakice, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme për të paguar këtë shtëpi në vitin 2006, të përbëra nga të ardhurat nga pagat si gjyqtar; të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti si notere; të ardhurat e përfituara nga qiratë e shtëpisë në Shkodër, dyqanit 63 m² te Shallvaret dhe ambjentin në Blv “****”.

2.3 Nuk bie dakord me shumicën për konkluzionin e arritur në këtë rast se, për arsye të vlerës së madhe monetare, e rrethanave të çështjes, sqarimet e subjektit të rivlerësimit nuk paraqitën asnjë element që të provonte transaksionin e kryer mes z. Broci dhe z. Gj, e të bindin trupin gjykues për të kundërtën e rezultateve të hetimit, për arsyet më poshtë:

2.3.1 Në vitin 2010, duke qenë se nuk ishte kryer regjistrimi hipotekor i kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ia ka kaluar me veprim juridik noterial dhe të regjistruar të drejtat reale të pronësisë së kësaj prone z. F. Gj.

2.3.2 Kjo kontratë plotëson kushtet e vlefshmërisë për shkak të formës, sipas nenit 83 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, për të sjellë pasojat juridike të synuara nga palët.

2.3.3 Vërtetësia dhe ligjshmëria e kontratës së shitjes së këtij sendi të paluajtshëm u provua me deklarimet e blerësit (konkretisht z. Gj.) të thirrur si dëshmitar para Komisionit

2.3.4 Z. F. Gj deklaroi para Komisionit se blerjen e kësaj shtëpie ai e kishte deklaruar pranë ILDKPKI-së si subjekt i deklarimit të pasurisë, në deklaratën e pasurisë për herë të parë të vitit 2013, në funksionin e drejtorit të përgjithshëm të METE-s.

2.3.5 Mbas analizimit të deklaratës së pasurisë për herë të parë, të vitit 2013, rezultoi se ai e ka deklaruar banesën e mësipërme si pasuri të blerë në vlerën 102.000 euro, nga subjekti i rivlerësimit, duke e shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

2.3.6 Shkresa me nr. ***, datë 10.05.2017, e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, drejtuar ILDKPKI-së, evidenton faktin se:

“Më datë 15.04.2010, shtetasi Artan Broci (pala shitëse) ka lidhur një kontratë të llojit prenotim dhe dorëzim për një apartament në shumën prej 102.000 eurosh, me palë blerëse shtetasin F. Gj”, duke provuar kryerjen e këtij veprimi nga palët.

2.3.7 Në vitin 2010, kohë kur është kryer veprimi juridik, nuk ka pasur një rregullim specifik për lëvizjet monetare midis personave fizikë te noteri, pasi Udhëzimi nr. 6915/2 ka dalë më datë 30.01.2012, “Mbi procedurat teknike për derdhjen e pagesës së tjetërsimit në llogarinë bankare të noterit”, “Udhëzim i përbashkët i ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 183, dhjetor 2012, botuar më datë 17.01.2013

2.4 Vlerësoj se në analizim të provave,dhe fakteve te mësipërme është arritur të provohet transaksioni i kryer mes z. Broci dhe z. Gj, duke u arritur të provohet mënyra e përfitimit të pagesës prej shitjes së kësaj pasurie, nga ana e subjektit të rivlerësimit.

2.5 Nuk bie dakord me shumicën për konkluzionin e arritur se subjekti ka kryer deklaram të rremë lidhur me vlerën reale të blerjes së kesaj pasurie për arsyet më poshtë:

2.5.1 Subjekti i rivlerësimit Artan Broci ka paraqitur një kontratë noteriale datë 6.9.2006 “Kontratë Porosie”, mes tij dhe shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. kundrejt shumes 55.140 euro

2.5.2 Bazuar në nenin 705 të Kodit Civil kontrata e shitjes ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi, si elementi kryesor i kontratës së shitjes.

2.5.3 Neni 690 i Kodit Civil parashikon se kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët

2.5.4 Këstet e paguara nga subjekti i rivlerësimit sipas parashikimeve të kontratës kanë qenë:

-kësti i parë 20 mijë euro, është paguar nga subjekti i rivlerësimit në zyrën noteriale kur u lidh kontrata, sipas mandatit të firmosur e vulosur nga noteri.

-kësti i dytë 15 000 euro, është paguar nga subjekti i rivlerësimit sipas mandatit të dorëzuar pranë Komisionit ku u evidentua një korrigjim në emrin e subjektit të rivlerësimit, mandat ky i firmosur e vulosur nga administratori i “****”sh.p.k

-kësti i fundit 20,140 euro është paguar nga subjekti i rivlerësimit ,sipas mandatit të arkëtimit nr.36 datë 30.09.2007. Në këtë mandat të firmosur e vulosur nga administratori i “****” gjendet shënimi: zbritje në vlerën 5000 euro, arkëtim në vlerën 15.000 euro shpk, fakt ky i shpjeguar edhe nga subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ.

2.5.5 Nga ana e shumicës në pikën 65 të vendimit të saj janë krijuar dyshime nga dokumentacioni paraqitur dhe mandatet e arkëtimit mbi vlerën e blerjes së këtij apartamenti nga subjekti.

2.5.6 Vlerësoj se për sa kohë nga analizimi i provave nuk u arrit të gjenden e provohet e arsyetohet:

(i)se deklaramet e subjektit, nuk përputhen me faktet e provat e marra gjatë hetimit administrativ,

(ii)se çmimi i kontratës nuk reflekton çmimin e paguar për këtë pasuri nga subjekti i rivlerësimit,

(iii)se janë paraqitur deklarime me përmbajtje të ndryshme nga të dhënat e kontratës,

(iv)se përgjigjet e subjektit kanë qenë të pavërteta, të ndryshme dhe kontradiktore midis tyre,

2.5.7 Subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë ligjore se ka kryer deklarim të rremë lidhur me vlerën reale të blerjes së kesaj pasurie.

3. Sipas shumicës, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime kontradiktore lidhur me pasurinë e tij, siç janë rastet e parashikuara në pikat 40, 55 e 157 të vendimit të saj.

Nuk bie dakord me shumicën për konkluzionin e arritur në këtë rast se, për sa më poshtë vijon:

3.1 Për pasurinë apartament, me sip. 143.81 m², në Rr. “**”,(pika 40)**

3.1.1 Sipas shumicës, deklarimet e subjektit të rivlerësimit mbeten kontradiktore lidhur me sipërfaqen e ndërtimit të përmendur në kontratën e paraqitur si provë e re (46.3 m²) dhe deklarimit të subjektit të rivlerësimit, për këtë objekt, si shtesë anësore me sipërfaqe 65.7 m² në deklaraten “Vetting” dhe deklarimin periodik përkatës.

3.1.2 Nuk bie dakord me shumicën për konkluzionin e arritur në këtë rast, pasi vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk është pyetur ndonjëherë në lidhje me këtë mospërputhje, në mënyrë që ai të ketë mundësi të japë shpjegimet e tij.

3.1.3 Vlerësoj se trupi gjykues duhet të vepronte si në vendimin nr. 54, datë 31.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ku mospërputhjet në sipërfaqet e banimit janë analizuar dhe pas analizimit dhe dëgjimit edhe të shpjegimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit, është arritur në konkluzion se ato duket se nuk janë të qëllimshme (pika 65 e vendimit).

3.1.4 Vlerësoj se, në respektim të dispozitave kushtetuese e ligjore, dhe në zbatim të parimit të barazisë para ligjit, analizimi i mospërputhjeve në sipërfaqe, nga i njëjti trup gjykues, për subjekte të ndryshme, duhet të argumentohet në mënyrë të paanshme e mbi bazën e të njëjtave parime, e në këtë rast nuk ka deklarime kontradiktore lidhur me sipërfaqen e ndërimit.

3.2 Sipas shumicës, ka deklarime kontradiktore lidhur me mënyrën e pagesës së kontratës, për likuidimin e vlerës për blerjen e zyrës së ndodhur në blv. “**”(pika 157)**

Nuk bie dakord me shumicën për konkluzionin e arritur për arsye se:

3.2.1 në lidhje me të ardhurat prej 21.000 USD për blerjen e ambientit zyrë, me vendndodhje bulevardi “****”, në vitin 2003, pasi në vijim të argumentimit lidhur me të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit nga unë si anëtare pakice, në pikën 1, të këtij mendimi pakice, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë se ka pasur të ardhura të ligjshme për pagimin e kështit të parë.

3.2.2 Ndërsa kështin e dytë arriti ta provojë se e ka paguar nëpërmjet kredisë së marrë në bankë dhe, nëpërmjet shpjegimeve, subjekti saktësoi edhe mospërputhjet e ndodhura në disbursimin e kredisë.

3.2.3 Bazuar në faktet dhe provat e referuara më lart, vlerësoj se nuk ka deklarime kontradiktore lidhur me mënyrën e pagesës së kontratës, për likuidimin e vlerës për blerjen e zyrës së ndodhur në blv. “****”

3.3 Sipas shumicës, ka deklarime kontradiktore lidhur me mënyrën e shkëmbimit e pagimin e pasurisë analizuar në pikat 44 deri 55 të vendimit të shumicës.

Nuk bie dakord me shumicën për konkluzionin e arritur për arsye se:

3.3.1 Subjekti i rivlerësimit banon në të njëjtën adresë nga viti 1996 me fqinjët, z. T. N dhe z. E. D. Subjekti i rivlerësimit banon në katin përdhe (katin e parë), z. D në katin e dytë dhe z. N në katin e tretë.

3.3.2 Në vitin 2011, z. N kishte vendosur ta shiste apartamentin e tij në katin e tretë.

3.3.3 Duke qene se banesa që shitej ishte në kat të tretë e banesa e subjektit të rivlerësimit në katin e parë, shkëmbimi i apartamentit të katit të dytë me atë të katit të tretë, u bë në mënyrë që të bënte lidhjen e dy apartamenteve të subjektit të rivlerësimit.

3.3.4 Në momentin e blerjes së apartamentit nga z. N, në korrik 2011, në muajin gusht 2011, ka kryer shkëmbimin e apartamentit të katit të tretë (tashmë si pronar i tij) me apartamentin e z. D në katin e dytë.

3.3.5 Në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes së apartamentit për katin e tretë në pronësi të z. N në fakt i ka paguar atij shumë prej 4 000 000 (katër milionë) lekë, e cila është tërhequr pranë “Banka Kombëtare Tregtare” sha (në vijim BKT), me përshkrimin blerje apartamenti,

3.3.6 Diferenca është paguar në shtator (*terhequr 3 000 000 lekë pranë BKT*), pasi ky ishte momenti që finalizonte dhe qëllimin e shkëmbimit të apartamenteve.

3.3.7 Bazuar në faktet dhe provat e referuara më lart, vlerësoj se nuk ka deklarime kontradiktore lidhur me mënyrën e shkëmbimit e pagimin e pasurisë analizuar në pikat 44 deri 55 të vendimit të shumicës.

4. Sipas shumicës, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka pasuri të fshehtë të padëklaruara

Nuk bie dakord me shumicën për konkluzionin e arritur për arsye se:

4.1 Hetimi administrativ evidentoi emrin e subjektit të rivlerësimit në sistemin *online* të faturimit të energjisë dhe ujit të lidhur për një banesë të ndodhur në Rrugën e ***.

4.2 Komisioni kreu një hetim të thelluar për këtë rast konkret, hetim i kërkuar edhe nga subjekti i rivlerësimit, dhenë përfundim të tij, nuk arriti të gjejë asnjë gjurmë që të provojë lidhjen e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri.

4.3 Nga ky hetim rezultoi se kjo pronë është e regjistruar në regjistrin hipotekor në emër të shtetasit A. B. Kjo pronë s'ka qenë asnjëherë e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

4.4 Nga ky hetim rezultoi se nga OSSHE-ja dhe UKT-ja nuk u arrit të gjendet as të provohet se ka pasur kontratë të lidhur për këtë pasuri, me subjektin e rivlerësimit. Për më tepër, këto institucione pranuan se bëhet fjalë për gabime që mund të ndodhin në sistemet e tyre.

4.5 Nga ky hetim nuk u evidentua dhe nuk u provua asnjë kontakt njohjeje apo miqësie midis pronarit të shtëpisë, shtetasit A. B, dhe subjektit të rivlerësimit.

4.6 Nga hetimi administrativ nuk u arrit të gjendet asnjë gjurmë që të provojë lidhjen e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri, nuk u arrit të provohet se e ka poseduar, ka përfituar prej saj, ka gëzuar frytet civile të saj.

4.7 Për arsyet, faktet dhe provat e referuara më lart, nuk ndaj të njëjtin mendim me shumicën për konkluzionin e arritur në këtë rast, pasi, pa u provuar lidhja e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri, vlerësoj se nuk mund të arrihet në konkluzionin se ndodhemi përpara gjetjes dhe evidentimit të pasurive të paligjshme e të padëklaruara dhe në kushtet e nenit D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës.

5. Sipas shumicës gjatë vlerësimit të pasurisë u konstatuan të paktën dy raste, për të cilat ai gjendet në situatën e konfliktit të interesit, të shprehura në pikat 58, 59 e 131 të këtij vendimi.

Nuk bie dakord me shumicën për konkluzionin e arritur për arsye se:

(i) Gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 6 i KEDNJ-së, neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 72 i Kodit të Procedurës Civile. Sipas argumentimit të vendimit nr. 25, datë 11.06.2013, të Gjykatës Kushtetuese, drejtësia jo vetëm të bëhet, por gjithashtu të shikohet që bëhet, provueshmëria e anësisë duhet të kalojë dy testet (i) testin subjektiv, i cili duhet të provojë që bindja personale apo interesi ka ndikuar në vendimin e gjykatës, e paanshmëria e gjyqtarit duhet të prezumohet deri sa të provohet e kundërta (ii) testin objektiv, i cili duhet të provojë se ka fakte bindëse që vënë në dyshime paanshmërinë.

(ii) Unë dhe anëtarët e shumicës, si trup gjykues, me vendimin nr. 26, datë 21.06.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, kemi marrë në shqyrtim dhe kemi analizuar në lidhje me konfliktin e mundshëm të interesit të subjektit të rivlerësimit, I.T., për situatën e mundshme të konfliktit të interesit, sepse rezultoi se ai kishte gjykuar çështje gjyqësore, me palë të përfaqësuara nga dorëzanësi i tij (pronari i shtëpisë së vendosur kolateral në bankë) për kredinë e marrë nga subjekti i rivlerësimit, pasi kemi analizuar situatën, kemi konkluduar sipas shpjegimeve të ILDKPKI-së (dhe sipas propozimit të relatorit të njëjtë te 2 çështjet) se subjekti i rivlerësimit, I. T., nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, pasi:

Së pari: Nuk gjendemi para një konflikti faktik të interesit, pasi interesi faktik i zyrtarit nuk rezulton se ka ndikuar apo mund të ndikojë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësiive shtetërore në kuptim të nenit 3, pika 4, germa "a", të ligjit.

Së dyti: Parimi i interesit të supozuar të gjyqtarit, që mund të ngrejë dyshime për ekzistencën e një konflikti në dukje të interesit, nuk ka ndodhur dhe as ka pasur mundësi të ndodhë, pasi vendimet gjyqësore nuk kanë asnjë ndikim mbi interesat e supozuara të gjyqtarit dhe se nuk rezultojnë ndonjë lidhje mes interesit të supozuar dhe vendimmarrjes gjyqësore konkrete, të tilla që ato, për këtë shkak dhe vetëm për të, të jenë të padrejta.

Së treti: Nuk gjendemi përpara një konflikti të mundshëm të interesit, sepse interesi i supozuar nuk ekziston tashmë dhe as nuk ekziston mundësia që në të ardhmen të vihet në diskutim.

(iii) Në respektim të dispozitave kushtetuese e ligjore, vlerësoj se situatat e konfliktit të interesit nga i njëjti trup, për subjekte të ndryshme, duhet të argumentohet në mënyrë të paanshme e mbi bazë të të njëjtave parime, mbi parimin e barazisë para ligjit, gjithmonë në interpretim të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të konfliktit të interesit, prandaj:

5.1 Për situatën e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit si anëtar i kolegjit civil që ka marrë vendimin nr. 00-2014-1258, me nr. 11243-01783-00-2014 regjistri themeltar, më datë 22.05.2014, me paditës L. Q, të paditur AKKP-në dhe palë të tretë ZVRPP-në Berat dhe z. T. N.

5.1.1 Nga hetimi administrativ u provua se subjekti i rivlerësimit, si anëtar i kolegjit civil që ka marrë vendimin nr. 00-2014-1258, më datë 22.05.2014, ka gjykuar vetëm ankimin e veçantë të palës në fjalë për të vlerësuar përfundimisht dhe ekskluzivisht vetëm çështjen se cila gjykatë e shkallës së parë do të ishte kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e mosmarrëveshjes.

5.1.2 Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në lidhje me rastet e papajtueshmërisë së gjyqtarit, në çështjen “Thomman, kundër Zvicrës”, ka mbajtur qëndrimin se “...nëse një vendim ndalon në apel dhe rikthehet në shkallën e parë të gjykatës për marrjen e një vendimi të ri, nuk konstatohet automatikisht shkelje e nenit 6, sepse i njëjti organ, me ose pa të njëjtën përbërje, do të vendosë përsëri mbi çështjen”.

5.1.3 Nuk bie dakord me shumicën, pasi vlerësoj se në këndvështrim të standardeve ligjore dhe fakteve të referuara më sipër, si anëtar i kolegjit civil që ka marrë vendimin nr. 00-2014-1258, më datë 22.05.2014, nuk ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë sipas nenit 6 të KEDNJ-së, nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile.

5.2. Sipas shumicës, subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e konfliktit të interesit pasi ka qenë anëtar i trupit gjykues të kolegjit civil të Gjykatës së Lartë, që ka marrë në shqyrtim çështjen civile me palë të paditur shoqërinë “****” sh.p.k., me vendimin nr. ***, datë 19.6.2014, të kolegjit civil të Gjykatës së Lartë.

5.2.1 Nga hetimi administrativ u provua se marrëdhënia juridike midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., e krijuar me kontratën e blerjes së apartamentit në Rashbull, ka përfunduar prej vitit 2010, kur subjekti i rivlerësimit e shiti këtë shtëpi dhe nuk rezultoi se subjekti ka pasur lidhje juridike a lidhje të tjera me këtë shoqëri, të tilla që ta bëjnë të interesuar në çështjet ku kjo shoqëri është palë.

5.2.2 Nga hetimi administrativ u provua se çështja është regjistruar për herë të parë në Gjykatën e Lartë në vitin 2010, është kaluar në dhomë këshillimi me vendimin e datës 11.01.2013 nga kolegji civil i asaj kohe mbi bazën e relacionit të përgatitur në atë kohë, ku janë evidentuar shkeljet e ligjit.

5.2.3 Subjekti i rivlerësimit është emëruar si anëtar i Gjykatës së Lartë me Dekretin e Presidentit të Republikës, nr. 8123, datë 26.04.2013, dhe ka filluar detyrën më datë 01.05.2013, pra mbas 5 muajve që çështja kishte kaluar për gjykim.

5.2.4 Vendimi ku ka marrë pjesë subjekti i rivlerësimit në vitin 2014 ka qenë pasqyrim i gjetjeve të dhomës së këshillimit të janarit 2013.

5.2.5 Nuk bie dakord me shumicën, pasi vlerësoj se në këndvështrim të standardeve ligjore dhe fakteve të referuara më sipër, si anëtar i trupit gjykues të kolegjit civil të Gjykatës së Lartë, që ka marrë në shqyrtim çështjen civile vendimi nr. ***, datë 19.6.2014, nuk ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë sipas nenit 6 të KEDNJ-së, nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile.

5.2.6 Nuk bie dakord me konkluzionin e arritur nga shumica për cenimin e besimit të publikut nëpërmjet këtij vendimi, pasi vlerësoj se besimi i publikut te drejtësia dhe respekti për gjyqësorin janë garanci e demokracisë dhe stabilitetit në një vend demokratik. Prandaj, pa u shtjelluar, argumentuar e provuar se përse ky vendim i subjektit të rivlerësimit konsiderohet përtej standardeve profesionale dhe etike, aq sa cenon besimin e publikut, shkarkimi i subjektit të rivlerësimit nuk mund të bazohet në nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

6. Sipas shumicës, numri i lartë i denoncimeve dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese, nr. *, datë 19.07.2016**, botuar në Fletoren Zyrtare nr. *** të vitit 2016, si fakt i prezumuar nga ligji në bazë të nenit 49, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, janë arsye për të cilat subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

6.1 Arsyetimi mbi vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 19.07.2016, vlerësoj se duhet të bëhet duke mbajtur në konsideratë sa parashikohet nga vendimi nr. 2 /2017 i Gjykatës Kushtetuese: *“Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqësorit të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësisë profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)”*, ndaj ky vendim nuk mund të shërbejë si provë për cenimin e besimin të publikut te sistemi i drejtësisë.

6.2 Numri i lartë i denoncimeve duhet të analizohej si në raste të tjera (vendimi nr. 26, datë 21.06.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit), në mënyrë që pas shqyrtimit të denoncimeve të paraqitura, të tregoheshin indicet e gjetura edhe të argumentohet se përse këto indice të gjetura përbënin shkak që cenojnë besimin e publikut; shkarkimi i subjektit të rivlerësimit nuk mund të bazohet në nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

Nga rrethanat e faktit dhe të dhënat që kanë mundur të administrohen nga hetimi administrativ, por edhe nga shpjegimet e provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, shpreh bindjen e bazuar në prova se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Broci, nuk ndodhet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, titulluar “Shkarkimi nga detyra”. Niveli i konstatimeve në lidhje me pasuritë, vlerësimin e figurës dhe vlerësimin profesional, marrë në tërësinë e tyre, duke marrë në konsideratë dhe qëndrimin e subjektit të rivlerësimit, nuk plotësojnë kriteret dhe shkaqet që përlligjin marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Broci. Për të gjitha argumentet e mësipërme vlerësoj se duhet të gjente zbatim neni 59/1 i ligjit nr. 84/2016, e shumica nuk duhet të kishte disponuar shkarkimin nga detyra të këtij subjekti, por konfirmimin e tij në detyrë.

ANËTARE

Xhensila PINE